

# UDHËZUES MBI HAPËSIRAT E MBYLLURA

Ky udhëzues u drejtohet punëdhënësve, menaxherëve dhe personave të tjerë brenda vendit të punës që kanë një përgjegjësi për shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.

Ky dokument duhet të përdoret si një mjet ndihme për të zhvilluar sistemet e sigurt të punës, ndërsa ndërmerren aktivitete në hapësira të mbyllura.



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija,

Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers

Inspektorati i Punës/ Inspektorata Rada/ Labour Inspectorate

# PËRMBAJTJA

HYRJE.....	3
FUSHËVEPRIMI DHE QËLLIMI .....	3
DEFINICIONET MBI HAPËSIRËN E MBYLLUR.....	2
ZVOGËLIMI APO ELIMINIMI I RREZIKUT TË HAPËSIRËS SË MBYLLUR.....	3
KËRKESAT PËR TË PUNUAR NË MËNYRË TË SIGURT NË HAPËSIRË TË MBYLLUR.....	4
AKSIDENTET QË LIDHEN ME AKTIVITETET NË HAPËSIRA TË MBYLLURA .....	6
PROCEDURAT EMERGJENTE – HAPËSIRAT E MBYLLURA .....	8
PAJISJET MBROJTËSE PERSONALE (PMP) .....	9
AUDITIMET .....	10
VËREJTJET PËRFUNDIMTARE.....	10



## HYRJE

Duke qenë në cilësinë e një punëdhënësi, ju duhet të mbronit punëtorët tuaj nga rreziku i lëndimit dhe dëmtimi i shëndetit nga detyrat e rrezikshme që kryhen në hapësira të mbyllura në vendin e punës. Ky udhëzues do t'ju ndihmojë ta arrini këtë gjë. Ky udhëzues përfshinë filtra të thjeshtë të rrezikut për t'ju ndihmuar të identifikoni se cilat aktivitete në hapësira të mbyllura janë të rrezikshme.

Hapësirat e mbyllura mund të jenë vdekjeprurëse. Shumë njerëz në botë vriten ose lëndohen rëndë në hapësira të mbyllura çdo vit. Këtu jo vetëm që përfshihen njerëzit që punojnë në hapësira të mbyllura, por edhe ata të cilët nuk janë të trajnuar dhe nuk posedojnë pajisjet e duhura, por që përpiqen t'i shpëtojnë të tjerët kur ndodhen në rrezik. Prandaj, është e rëndësishme të zbatohen praktika të mira sigurie për të krijuar një mjedis të sigurt pune për të gjithë.

## FUSHËVEPRIMI DHE QËLLIMI

Qëllimi i këtij udhëzuesi është të ofrojë informacion për identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin e rreziqeve që vijnë nga aktivitetet në hapësirat e mbyllura në vendet e punës për të parandaluar aksidentet dhe incidentet gjatë zhvillimit të aktiviteteve të tilla.

Qëllimi i këtij Udhëzuesi është të ofrojë këshilla dhe udhëzime në përmbushjen e kërkesave për të punuar në mënyrë të sigurt në hapësira të mbyllura. Në rastin ideal, puna në hapësira të mbyllura duhet të shmanget, por në situata kur kjo një gjë e tillë është e pamundur, atëherë është e domosdoshme të identifikohen rreziqet e pranishme, të vlerësohen ato dhe të përcaktohet se cilat janë masat paraprake thelbësore për t'i mbrojtur individët, të cilët kryejnë një punë të tillë.

Ky material do të shërbejë si një standard referimi për praktikatat e pranueshme për vendet e punës në hapësira të mbyllura në Kosovë. Shpresojmë që ky Udhëzues do të rezultojë në një standard më të lartë të mbrojtjes për të gjithë personat që janë të përfshirë në aktivitete në hapësira të mbyllura gjatë punës së tyre. Është e pamundur të sigurohen hollësi që mbulojnë çdo situatë të hapësirave të mbyllura të punës. Parimet e dhëna këtu mund të përshtaten për t'u zbatuar në një sërë veprimesh në hapësirat e mbyllura.



# DEFINICIONET MBI HAPËSIRËN E MBYLLUR

## Çfarë është një hapësirë e mbyllur?


Një hapësirë e mbyllur është një hapësirë me hyrje dhe dalje të mbyllur dhe jo të përshtatshme për njerëz. Një hapësirë e mbyllur përcaktohet nga rreziqet që shoqërojnë nga një sërë rrethanash specifike, dhe jo vetëm, sepse puna kryhet në një hapësirë të mbyllur. Shumë vende pune përmbajnë zona që konsiderohen si "hapësira të mbyllura" sepse megjithëse nuk janë krijuar domosdoshmërisht për njerëzit, ato janë mjaft të mëdha që

Një hapësirë mbyllur nënkupton një hapësirë të izoluar ose pjesërisht të izoluar që:

- 1 Nuk është projektuar ose synuar kryesisht për të zënë një person;
- 2 Është ose ka të ngjarë të jetë një rrezik për shëndetin dhe sigurinë nga: një atmosferë që nuk ka një nivel të sigurt oksigjeni, ose ka ndotës, duke përfshirë gazrat e ajrit, avujt dhe pluhurat, që mund të shkaktojnë lëndime nga zjarri ose shpërthimi, ose përqendrime të dëmshme të ndonjë ndotësi të ajrit, ose përmbajtje;
- 3 Dhe është, ose është projektuar ose synuar të jetë, në presion normal atmosferik ndërsa personi është në atë hapësirë.

punëtorët të hyjnë dhe të kryejnë punë të caktuara.

**Hapësirat e mbyllura përfshijnë, por jo vetëm, cisternat, anijet, rezervuarët, koshat e magazinimit, hinkat, qemerët, gropat, pusetat, tunelet, depot e pajisjeve, kanalet, tubacionet, etj.**





# ZVOGËLIMI APO ELIMINIMI I RREZIKUT TË HAPËSIRËS SË MBYLLUR

Metoda më efektive për minimizimin e rreziqeve të hapësirës së mbyllur është të evitohet hyrja në këto mjedise. Kjo mund të arrihet duke siguruar që cisternat, rezervuarët dhe pusetat të kenë masa alternative për të lehtësuar nevojën për t'u futur në to për të përfunduar punën.

Sidoqoftë, nuk është gjithmonë e mundur të eliminohet nevoja për të hyrë në një hapësirë të mbyllura, prandaj është e rëndësishme të kuptoni pajisjet në dispozicion për të zvogëluar rreziqet në këto zona. Individëve gjithashtu do t'u duhet të sigurojnë që të vendosin procedura adekuate të hyrjes dhe daljes, krahas politikave të emergjencës, që i komunikohen çdo personi që mund të qëndrojë pranë dhe të ndihmojë nëse diçka shkon keq.

**Është e rëndësishme të ndiqni hapat në hierarkinë e masave të kontrollit për të menaxhuar rreziqet e identifikuara:**



Figura 1 – hierarkia e masave të kontrollit



# KËRKESAT PËR TË PUNUAR NË MËNYRË TË SIGURT NË HAPËSIRË TË MBYLLUR

Kur ndonjë person hynë ose kryen ndonjë punë në një hapësirë të mbyllur, punëdhënësi dhe/ose drejtori duhet të respektojnë në mënyrë rigoroze rregullat.

Personi përgjegjës duhet të sigurojë hyrjen/punën e sigurt në hapësira të mbyllura. Kjo përfshin:

- Identifikimin/regjistrimin/shenjat paralajmëruese /informatat për të gjitha hapësirat e mbyllura në vendin e punës;
- Vlerësimin e nevojës për hyrje në hapësirën e mbyllur;
- Mjetet e sigurta të hyrjes dhe daljes nga hapësira e mbyllur;
- Praktikat e sigurta për hapjen e hyrjes së një hapësire të mbyllur;
- Ndriçimin e mjaftueshëm dhe të përshtatshëm për hyrje ose punë në një hapësirë të mbyllur;
- Ventilimin adekuat të hapësirës me ajër të pastër para hyrjes dhe gjatë punës në një hapësirë të mbyllur;
- Procedurat dhe kontrollin e hyrjes në një hapësirë të mbyllur përfshirë testimin e gazit;
- Trajnim mbi sigurinë dhe shëndetin për të punuar në hapësira të mbyllura për punëtorët dhe mbikëqyrësit;
- Operacionet e shpëtimit emergjent në hapësira e mbyllura të cilat përfshijnë krijimin e një plani shpëtimi dhe sigurimin e pajisjeve të shpëtimit për hapësirën e mbyllur;
- Caktimin e një shoqëruesi në hapësirën e mbyllur; dhe që
- Punëtori të jetë i stërvitur për të punuar në hapësira të mbyllura.





## 1. Elementet kryesore të vlerësimit të rrezikut për hapësira të mbyllura

Kryerja e vlerësimeve të rrezikut është çelësi për zvogëlimin e rreziqeve në lidhje me hyrjen dhe punën në hapësira të mbyllura. Të gjithë, nga punëdhënësi te punëtori, duhet të punojnë së bashku për të siguruar që procesi i vlerësimit të rrezikut identifikon çdo rrezik të mundshëm dhe të miratojë të gjitha masat arsyeshëm të mundshme për ta bërë hapësirën e mbyllur të sigurt për të hyrë dhe për të punuar. Është e rëndësishme që vlerësimi i riskut në punën në hapësirën e mbyllur drejtohet nga një personel i ditur dhe me përvojë.

## 2. Vlerësoni nevojën për të hyrë në një hapësirë të mbyllur

Para se të përpiqeni të hyni ose të punoni në një hapësirë të mbyllur, është e rëndësishme të merrni në konsideratë mundësinë e përdorimit të alternativave dhe metodave të tjera për të bërë punën pa hyrë në hapësirën e mbyllur. Hyrja ose puna në një hapësirë të mbyllur duhet të jetë vetëm një mundësi e fundit.

## 3. Identifikimi dhe vlerësimi i hapësirave të mbyllura

Të gjitha hapësirat e mbyllura duhet të identifikohen, dokumentohen dhe etiketohen qartë. Duhet të përfshihet çdo pajisje brenda hapësirës së mbyllur. Dokumenti duhet të përmbajë të dhënat e llojeve të hapësirave të mbyllura dhe shërbimet e tyre. Për regjistrimin e pajisjeve, është e rëndësishme të përfshini gjithashtu llojin dhe numrin e identifikimit. Është me shumë rëndësi të identifikohet dhe vlerësohet çdo hapësirë e mbyllur për të përcaktuar nëse ajo paraqet rreziqe kimike ose fizike. Është e këshillueshme të mos supozoni se një hapësirë e mbyllur është pa rreziqe.

Rreziqe të ndryshme kimike dhe fizike mund të shfaqen përmes aktiviteteve të ndryshme të punës brenda hapësirës së mbyllur. Rreziqet kimike përfshijnë kushte të tilla si tymi dhe pluhuri që ndikojnë në ajrin e hapësirës së mbyllur dhe mund të jenë të djegshme, toksike, gërryese ose asfiksuese. Mënyra e vetme për të identifikuar një rrezik atmosferik është kryerja e provave të gazit nga jashtë. Rreziqet fizike përfshijnë kushte të tilla si pajisjet e mekanizuara, materialet e lira, zhurma e tepërt, temperaturat ekstreme, lagështia, ndriçimi i ulët dhe vështirësitë e qasjes.

Është gjithashtu e nevojshme të shfaqen shenja paralajmëruese në ose afër çdo pike hyrjeje në një hapësirë të mbyllur për të paralajmëruar personat për rreziqet e mundshme.





# AKSIDENTET QË LIDHEN ME AKTIVITETET NË HAPËSIRA TË MBYLLURA

Puna në hapësira të mbyllura mund të paraqesë rreziqe serioze për njerëzit që duhet të hyjnë në to. Ka pasur shumë vdekje të evitueshme nga një punë e tillë. Rreziqet përfshijnë asfiksion ose helmim të mundshëm nga atmosfera brenda hapësirës së mbyllur dhe lëndime fizike dhe fiziologjike dhe sëmundje që lidhen me punën në hapësira të ngushta.

**Është absolutisht thelbësore që, para se të ndërmerret ndonjë punë në një hapësirë të mbyllur, puna e propozuar të vlerësohet dhe planifikohet plotësisht.** Duhet menduar me kujdes për nevojën e hyrjes ose nëse mund të përdoren metoda alternative, si dhe për aftësitë e atyre që janë të përfshirë në punë.

Shumë punëtorë lëndohen dhe vriten çdo vit ndërsa punojnë në hapësira të mbyllura. Rreth 60% e viktimave kanë qenë në mesin e ekipit të shpëtimit. Një hapësirë e mbyllur mund të jetë më e rrezikshme sesa hapësirat e rregullta të punës për shumë arsye.

**Për të kontrolluar në mënyrë efektive rreziqet që lidhen me punën në një hapësirë të mbyllur:**

- Një program i vlerësimit dhe kontrollit të rreziqeve të hapësirës së mbyllur duhet të zbatohet për vendin tuaj të punës.
- Nëse hapësira e mbyllur nuk mund të bëhet e sigurt për punëtorin duke ndërmarrë masa paraprake, atëherë punëtorët NUK duhet të hyjnë në hapësirën e mbyllur derisa të mos jetë e sigurt për të hyrë në atë hapësirë me mjete shtesë.
- Të gjitha hapësirat e kufizuara duhet të konsiderohen të rrezikshme përveç nëse një person kompetent ka vendosur ndryshe përmes një vlerësimi të rrezikut.



Puna në një hapësirë të mbyllur është identifikuar si një aktivitet me rrezik të lartë në mjedise të ndryshme industriale.



Shpesh përcaktohet si një hapësirë mjaft e madhe për të hyrë punëtorët, me mjete të mbyllura ose kufizuara për hyrje ose dalje, dhe jo e dizajnuar për shfrytëzim të vazhdueshëm. Hapësira e mbyllur është e zakonshme në fabrika dhe vende prodhimi.

Një studim gjithëpërfshirës i sigurisë në punë i kryer në vitin 2017 arriti në përfundimin se "nga llojet e aksidenteve, ato që lidhen me aktivitete në hapësira të mbyllura kanë raportin më të lartë të fataliteteve në krahasim me lëndimet tjera". Shkalla e përgjithshme e fatalitetit në punën në hapësira të mbyllura vlerësohet të shkojë mes 0,05 dhe 0,08 për 100,000 punëtorë. Ky është realiteti edhe pse çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë në hapësira të mbyllura kanë marrë një vëmendje të madhe në literaturën e sigurisë në punë, si dhe në praktikatat dhe procedurat e vendit të punës në industri.

Në mënyrë që të kuptojmë më mirë, duhet të shohim arsye themelore që çojnë drejt aksidenteve.

**Cilat janë rreziqet më të zakonshme në hyrje të hapësirës së mbyllur?**



**Figura 2 – 4 shkaqet kryesore të aksidenteve në hapësira të mbyllura që çojnë në lëndime**

Burimi: <https://blog.gasmet.com/confined-space-entry-4-main-causes-of-serious-accidents>



# PROCEDURAT EMERGJENTE – HAPËSIRAT E MBYLLURA

Një person që zhvillon një biznes ose ndërmarrje duhet të vendosë procedurat e ndihmës së shpejtë dhe të shpëtimit që do të ndiqen në raste emergjente dhe të sigurojë që ato procedura janë duke u zbatuar, sipas nevojës, për të siguruar që ato janë efikase dhe efektive. Në rast të emergjencës procedurat e ndihmës së shpejtë dhe të shpëtimit duhet të fillojnë nga jashtë hapësirës së mbyllur sa më shpejt që të jetë e mundur.

Personi që zhvillon një biznes ose ndërmarrje duhet gjithashtu të sigurojë që hapësirat për hyrje dhe dalje të jenë të një madhësie të mjaftueshme për të lejuar hyrjen në raste emergjente; hapësirat nuk duhet të kenë pengesa; dhe çdo mjet, instrument apo pajisje mbrojtëse personale e siguruar për ndihmën e shpejtë ose për shpëtim emergjent duhet të mbahet në gjendje të mirë pune.

**Kur vendosni procedurat e emergjencës, faktorët e mëposhtëm duhet të merren parasysh për të menaxhuar rreziqet që lidhen me hapësirat e mbyllura:**

- 1.** Nëse puna mund të kryhet pa pasur nevojë për të hyrë në hapësirën e mbyllur
- 2.** Natyrën e hapësirës së mbyllur
- 3.** Çdo ndryshim që shoqërohet me përqendrimin e oksigjenit ose përqendrimin e ndotësve të ajrit në hapësirën e mbyllur
- 4.** Puna që do të kryhet në hapësirën e mbyllur, gama e metodave me të cilat mund të kryhet puna, metoda e propozuar e punës dhe lloji i procedurave të kërkuara të urgjencës dhe shpëtimit.





## PAJISJET MBROJTËSE PERSONALE (PMP)

Është thelbësore të bëhet një vlerësim i duhur i kushteve dhe të identifikohen proceset e punës që kërkojnë pajisje mbrojtëse shtesë për detyrën që do të ndërmerret. Për shembull, mundësia e ekspozimit personal ndaj substancave toksike kërkon shqyrtimin e pajisjeve të plota mbrojtëse të frymëmarrjes (PMF).

Është e nevojshme të sigurohen pajisjet e duhura të ndihmës së shpejtë dhe t'i vihen në dispozicion për raste emergjente. Është e rëndësishme të keni njerëz të trajnuar për dhënien e ndihmës së parë, të cilët do të merren me dëmtimet e parashikueshme.

Është thelbësore të mirëmbahen dhe inspektohen të gjitha pajisjet e parashikuara për një rast emergjent. Inspektimi gjithashtu përfshin ekzaminime dhe teste periodike në përputhje me udhëzimet e prodhuesit ose kërkesat e duhura të legjislacionit të shëndetit dhe sigurisë.

Ekzaminimi i litarëve, pajisjeve lidhëse, litarëve të shpëtimit, mbërthyesve dhe pajisjeve të tjera speciale, normalisht do të përbëhet nga një ekzaminim i plotë vizual i të gjitha pjesëve të tyre për përkeqësim ose dëmtim, në veçanti, ato pjesë që janë të destinuara për të bartur ngarkesa. Është e nevojshme që ekzaminimet të kryhen rregullisht dhe të mbahet një regjistër për këto ekzaminime.

Është e nevojshme të merren certifikatat e testimit dhe ngarkesës së sigurt të punës kur blini pajisje të cilat duhet të ngritën lart, të tilla si litarë, pajisje lidhëse, litarët e shpëtimit, mbërthyes, etj. Është e nevojshme të hidhni në mbeturina ose asgjësoni pajisjen nëse është e dëmtuar. Përndryshe, duhet t'ia ktheni prodhuesit ose riparuesve të tjerë kompetentë të cilët mund ta riparojnë atë dhe të sigurojnë një certifikim të ri të testit dhe ngarkesës së sigurt të punës për pajisjet e riparuar.

Pajisjet e përshtatshme të komunikimit janë të nevojshme për hapësirat e mbyllura. Këto pajisje komunikimi mund të lehtësojnë gjithashtu shpëtimin në hapësira të mbyllura duke kursyer kohë në transmetimin e udhëzimeve dhe informacionit mjekësor. Komunikimi i besueshëm mund të ketë një efekt qetësues tek ata që janë duke u shpëtuar, duke ndikuar që operacioni të kryhet me më efikasitet.





## AUDITIMET

Punëdhënësi duhet të ketë auditime të brendshme/vetë-inspektime sipas listës së sugjeruar në Shtojcë. Një gjë e tillë do t'u mundësojë atyre që të menaxhojnë në mënyrë efektive shëndetin dhe sigurinë dhe gjithashtu t'i përgatisë ata për çdo auditim të jashtëm siç janë Rregullatori (Inspektorati i Punës etj.) dhe Certifikimi, nëse ka të tilla.

## VËREJTJET PËRFUNDIMTARE

**MBANI MEND:** Si punëdhënës, ju duhet të mbroni punëtorët tuaj nga rreziku i lëndimit dhe dëmtimit të shëndetit nga detyrat e rrezikshme të hapësirave mbyllura në vendin e punës. Për ta bërë këtë, ju duhet të menaxhoni rreziqet e identifikuar, të siguroheni që ekzistojnë procedurat e veprimit në raste emergjente dhe të siguroni pajisje të përshtatshme të mbrojtëse personale dhe pajisje të ndihmës së shpejtë për ata që punojnë në hapësira të mbyllura.

**Për më shumë informata, kontaktoni Inspektoratin e Punës.**